

Hapet thirrja për bursa shkëmbimi për studime në kuadër të Programit Erasmus + për studentët e UT-së në Vilnius Gediminas Technical University, Lituani.

Në kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës për semestrin e dytë të vitit akademik 2017-2018 në Vilnius Gediminas Technical University, Lituani.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

-Shkëmbimin e studentëve për studime;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor;
- Master;
- PhD;

Kohëzgjatja e bursave:

- Bachelor (1 semester);
- Master (1 semester);
- PhD (1 semester);

Fushat e studimit:

- Komunikim,
- Shkenca Sociale,
- Mediat Sociale
- Administrim Biznes;
- Ekonomiks;
- Marketing;

Për t'u njohur me programin e studimit në gjuhën angleze të ofruar nga Vilnius Gediminas Technical University klikoni në adresën:

<http://www.vgtu.lt/for-international-students/degree-programmes-in-english-language/50775>

Bursat përfshijnë:

-Kompensimin mujor për studentët (750 EUR në muaj);

-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës);

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Bachelor:

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Lista e notave për nivelin Bachelor (e përkthyer në anglisht);
- Vërtetim studentit (i përkthyer në anglisht);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Certifikatë e gjuhës së huaj (niveli B2);
- *Dokumenti Learning Agreement;

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Diplomë dhe Lista e notave për nivelin Bachelor (e përkthyer në anglisht);
- Lista e notave për nivelin Master (e përkthyer në anglisht);

- Vërtetim studenti (i përkthyer në anglisht);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Certifikatë e gjuhës së huaj (niveli B2);
- *Dokumenti Learning Agreement;

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit PhD:

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Diplomë dhe Lista e notave për nivelin Bachelor (e përkthyer në anglisht);
- Diplomë dhe Lista e notave për nivelin Master (e përkthyer në anglisht);
- Lista e notave për nivelin PhD (e përkthyer në anglisht);
- Vërtetim studenti (i përkthyer në anglisht);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Certifikatë e gjuhës së huaj (niveli B2);
- *Dokumenti Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before Mobility”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës ndërsa në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Vilnius Gediminas Technical University lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik në nivel Fakulteti, më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus + Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën: http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf

Afati për aplikim: 01 Nëntor 2017

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al me subjekt: “Aplikim për bursë në Vilnius Gediminas Technical University, emrin dhe mbiemrin tuaj”.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!